



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Bujqësisë
Periudha raportuese	Shtator 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Shkumbin Gashi

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Duke u bazuar në planprogramin e punës në kuadër të Drejtorisë, brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit, fermerë, shoqata të ndryshme, institucione të ndryshme etj.

Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara në programin e punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

- Vazhdojnë vizitat monitoruese tek fermerët përfitues të pajisjeve bujqësore gjatë vitit 2019;
- Vazhdojnë vizitat këshilluese te fermerët përfitues nga Komuna dhe donatorët e saj;
- Vazhdojnë vizitat tek fermerët aplikues për pajisje bujqësore gjatë muajit shtator në komunën e Prishtinës;
- Monitorimi i fermerëve gjatë kultivimit të kulturave bujqësore në sektorin e pentarisë;
- Vazhdojnë vizitat tek aplikuesit ne sektorin e shpendarisë (furnizim me ushqim të koncentruar), për pula vojëse;
- Vizita studimore në shkëmbim të përvojave në kultivimin e bimeve aromatiko – mjekësore, në Pogradec;
- Vazhdon procesi i aplikimit për grante në thirrjen e hapur, nga data 20.08.2019 deri më 04.10.2019, për fermerët e komunës së Prishtinës.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

- Janë realizuar rreth 69 vizita gjatë muajit shtator 2019, për subvencione dhe grante te fermerët përfitues të projekteve të financuara nga Komuna e Prishtinës dhe donatorët;
- Janë realizuar gjithsejt 5 vizita këshilluese rreth përdorimit të makinave mjelëse dhe kushtet e mbajtjes së qumështit të freskët në fermat blegtorale;
- Janë vizituar fermerët të cilet kanë aplikuar për paisje: makina mjelëse, mikserë 500kg/h, laktofrizë 500/l, spërkatëse për trajtimin e pemishteve me preparate kimike, me kapacitet 60/l), ku prej tyre janë shpallur 51 fermër përfitues;
- Janë realizuar 17 vizita monitoruese tek fermerët në sektorin e pemtarisë rreth përdorimit të masave agro dhe pomo-teknike;
- Është realizuar vizita studimore në qytetin e Pogradecit, ku kemi parë nga afër kultivimin e bimëve aromatiko-mjeksore, me ç'rast kemi shkëmbyer përvojat në këtë fushë;
- Procesi i aplikimit të fermerëve ka përfunduar, ku pritet të vazhdojë shqyrtimi i aplikacioneve të dorëzuara nga ana e tyre.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

- Vazhdon shqyrtimi i aplikacioneve për aplikuesit në thirrjen e hapur nga Drejtoria e Bujqësisë;
- Vazhdojnë vizitat monitoruese tek fermerët përfitues të pajisjeve bujqësore gjatë vitit 2019;
- Vazhdojnë vizitat këshilluese të fermerët përfitues nga Komuna dhe donatorët e saj.

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

- Nuk është planifikuar për këtë periudhë.

4.1.3 Takimet me palë

- Kemi pasur 14 takime.

5. Takimet me institucione të tjera

- Kemi pasur 1 vizitë studimore jashtë vendit.

6. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

- Nuk ka pasur.

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Nuk ka pasur kërkesa të tilla.

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

7. Takime të tjera

- Nuk ka pasur.

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh.: pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

- Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Planifikohet të hapet thirrja për aplikim për përkrahje në bletari (furnizim me koshere dhe pajisje në bletari);
- Planifikohet të hapet thirrja për aplikim për përkrahje të pemëtarëve me material fidanor (fidanë të arrave);
- Planifikohet të përkrahen fermerët me sistem të ujitjës dhe hapje të pusit për ujitjen e pemishteve ekzistuese;
- Planifikohet të bëhet hapja e thirrjes për aplikim për kultivuesit e perimeve në serra 500m² dhe përkrahje me serra të specializuara për kultivimin e fidanëve (ndërtimi i serrave 500m²);
- Planifikohet të hapet thirrja për aplikim në lëmin e shpendarisë (ngritja e fermave ekstensive për prodhimin e vezëve dhe misht në sistem të lirë të mbajtjes së pulave);
- Vazhdojnë vizitat monitoruese tek fermerët përfitues të pajisjeve bujqësore gjatë vitit 2019;
- Vazhdon monitorimi i fermerëve përfitues të subvencioneve dhe granteve nga Komuna e Prishtinës dhe donatorët.

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.